



Republika e Kosovës  
Republic of Kosova



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit  
Municipality Assambly of Elez Han

01/ Nr.849/2013

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11,12 , Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr. 04/L-165 neni 7 paragrafi 1.2, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, 03/L-048 neni 27, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.02.2012 mori:

## V E N D I M

**PËR BARTJEN E MJETEVE TË PA SHPENZUARA NGA TË HYRAT VETANAKE KOMUNALE TË VITIT 2011 DHE TË VITIT 2012 NË VITIN VIJUES 2013**

### I

Miratohet propozim vendimi me numër 02/Nr.849 /2013 për bartjen e mjeteve të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake komunale të vitit 2011 dhe të vitit 2012 në vitin vijues 2013.

### II

Të hyrat e bartura nga viti 2011 në vitin 2012 kanë qenë në shumën prej 87,958.30 € dhe prej tyre janë shpenzuar në shumën prej 81,547.33€. kurse për bartje kanë mbetur edhe 6,410.97€. Të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2012 kanë qenë në shumë prej 231,379.91 €, prej tyre të shpenzuara janë 169,308.91€, kurse për bartje janë edhe 62,071.40 €. Pra të hyrat vetanake të viteve 2011 dhe 2012 në total janë në shumën prej 68,481.97 €, të cilat i bartim për vitin 2013. Këto mjete i shpërndajmë në këto kategori ekonomike: paga dhe mëditje në shumë prej 153.18 €, mallra dhe shërbime në shumë prej 9,700.00 €, subvencione dhe transfere në shumë prej 5,721.60 € dhe në shpenzime kapitale në shumë prej 52,907.19 €.

### III

Në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje në shumë prej 153.18 € në programin arsim dhe shkencë (160) nën-programi (92175) shuma prej 153.18 €. Në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime në shumë prej 9,700.00 €, arsim dhe shkencë (160) nën-programi (92175) shuma prej 9,700.00€. Në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere në shumë prej 5,721.60 € në programin Bujqësia ,Pylltaria dhe Zhvillimi rural (470 ) nën-programi (47115) shuma prej 5,721.60 €.

Në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale në shumë prej 52,907.19 € , mjetet i bartim në programin planifikimi urban dhe mjedisi (660) nën-programi (66480) në shumë prej 49,907.19 € në projektet si vijon:

Projekti (86426) „Rregullimi i rrethojës së Varrezave të Dëshmorëve” në shumë prej 13,401.20 €, projekti (86416) „Rregullimi i kanalizimit fekal në lagjen Curri” në shumë prej 5,000.00€, projekti (88876) „Mjete të lira për Bashkëinvestime” në shumë prej 12,000.00 €, Projekti (88825) „Shtrimi me kubëza betoni nëpër fshatrat dhe rrugët që qojnë te varrezat (Seqishtë, Krivenik, Gorancë, Laq, Paldenicë, Lagjja e Ujit të Thartë) në shumë prej 10,000.00 €, projekti (88824) „Rregullimi dhe adoptimi i zyreve në objektin e komunës” në shumë prej 2,000.00€, projekti (86411) „Pajisje me teknologji informative të shkollave” (lloptop dhe projektor) në shumë prej 4.000.00€, projekti (88831) “Fond për hartimin e projekteve” në shumë prej 3,000.00 €.

Në programin Arsimi dhe shkenca, 920/94020 arsimi fillor në shume prej 3,000.00 € në projektin me kod (86430) „Rregullimi i infrastrukturës shkollore” në shume prej 3,505.99€.

#### IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës

#### V

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës

Hani i Elezit  
Data:01.03.2013

Kryesuesi i Kuvendit  
Menduh Vlasi





Republika e Kosovës  
Republic of Kosova



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit  
Municipality Assambly of Elez Han

01/ Nr.856/2013

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, neni 40.2 shkronja (d), Rregulloren e Punës së Kuvendit neni 15 shkronja (c), Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.02.2012 mori:

## V E N D I M

PËRMIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2012

### I

Miratohet raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2012.

### II

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës

### III

Me këtë vendim njoftohen: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 01.03.2013

Kryesuesi i Kuvendit  
Menduh Vlashi





Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit  
Municipality Assambly of Elez Han

01/Nr.121/2013

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12.2 shkronja (c), 40, Ligjit për Barazi Gjinore nr.2004/2 neni 4.14, Ligjit Kundër Diskriminimit numër nr.2004/3 si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit të Hanit të Elezit neni 15 shkronja (a), Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.02.2013 mori:

**V E N D I M**  
**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR BARAZI GJINORE**

**I**

Miratohet rregullorja me numër 02/Nr.121/2013 me tekstin e mëtejme Rregullorja për Barazi Gjinore.

**II**

Miratimi i këtij vendimi vjen pas propozimit të ekzekutivit të komunës dhe pas zhvillimit të gjithave procedurave ligjore, rregullorja ka për qëllim që të mbrohet, trajtohet dhe vendoset barazia gjinore si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë në komunën e Hanit të Elezit, mundësitë e barabarta të kontributeve të tyre në zhvillimin ekonomik, social, kulturor dhe në të gjitha fushat e jetës shoqërore.

**III**

Rregullorja përmban 12 nene dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

**IV**

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës.

**V**

Me këtë vendimi njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Administratë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data:01.03.2013

Kryesuesi i Kuvendit  
Menduh Vlasi





Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit  
Municipality Assambly of Elez Han

01/ Nr.860/2013

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 63, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur më datë 26.02.2013 mori:

## V E N D I M

### PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KRYETARIT PËR VITIN 2012

#### I

Miratohet raporti i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2012.

#### II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për periudhën Janar - Dhjetor 2012 i hartuar nga Kryetari Komunës dhe stafi i tij.

#### III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës

#### IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Administratës, Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria e Politikave Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik , Zyra e Prokurimit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit:  
Data: 01.03.2013

Kryesuesi i Kuvendit  
Menduh Vlasi





Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit  
Municipality Assambly of Elez Han

01/Nr.857/2013

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 11, neni 40, Ligji për menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit neni 46.2, Statutin e Komunës neni 75, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.02.2013 mori:

## V E N D I M

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE TË MJETEVE BUXHETORE PËR VITIN 2012

### I

Miratohet raporti i shpenzimeve buxhetore për vitin 2012 për komunën e Hanit të Elezit.

### II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Dhjetor 2012 i hartuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, në këtë raport përfshihen:

- Implementimi i buxhetit për periudhën janar - dhjetor 2012
- Progresi i shpenzimeve,
- Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik,
- Planifikimi i buxhetit, alokimit dhe shpenzimet,
- Pagat dhe kompensimet tjera,
- Raport i të hyrave vetanake sipas programeve,
- Përmbledhja e shpenzimeve në mallra dhe shërbime,
- Shërbimet komunale – komunalit,
- Subvencionet dhe transferet dhe
- Financimi vjetor i investimeve kapitale për vitin 2012.

### III

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

### IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data:01.03.2013

Kryesuesi i Kuvendit  
Menduh Vlasi





Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12.2 shkronja (c), 40, Ligjit për Barazi Gjinore nr.2004/2 neni 4.14, Ligjit Kundër Diskriminimit numër nr.2004/3 si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit të Hanit të Elezit neni 15 shkronja (a), Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.02.2013 mori:

## RREGULLORE PËR BARAZI GJINORE

### DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Neni 1

#### Qëllimi

- 1.Me këtë rregullore mbrohet, trajtohet dhe vendoset barazia gjinore si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë në Komunën e Hanit të Elezit, mundësitë e barabarta të kontributeve të tyre në zhvillimin ekonomik, social, kulturor dhe në të gjitha fushat e jetës shoqërore.
- 2.Përkatësia gjinore i referohet përcaktimit socio- kulturor të burrit dhe gruas, rrolit që lidhet me të gjitha aspektet e jetës, nevojave dhe interesave të tyre të veçanta.

#### Neni 2

#### Përkufizimet

- 1.1 “**Barazi gjinore** “ do të thotë pjesëmarrje e barabartë e femrave dhe meshkujve në të gjitha fushat e jetës, pozitë të barabartë, mundësi të barabarta për të gëzuar të gjithat të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në zhvillimin e shoqërisë si dhe të kenë përfitim të barabartë nga të arriturat e këtij zhvillimi.
- 1.2 “ **Trajtim i barabartë gjinor** “ do të thotë mënjanim i formave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të diskriminimit gjinor.
- 1.3 “**Diskriminim i drejtpërdrejtë gjinor** “do të thotë trajtim i pabarabartë i ndonjë individi në krahasim me një individ të gjinisë së kundërt në rrethana të njëjta apo të ngjashme.

**1.4 “Diskriminim i tërthortë gjinor “**do të thotë vënia e individit të njëres gjini në pozitë jo të barabartë me dispozitat asnjane, standartet apo trajtim të pabarabartë në rrethana të njëjta ose të ngjashme, përveç rasteve kur këto dispozita, standarte apo ky trajtim është i domosdoshëm dhe nëse mund të justifikohet me fakte objektive që nuk bazohen posaçërisht në ndonjërin gjini.

**1.5 “Parimin e trajtimit të barabartë “** që nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj personit, në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paaftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religjionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale, races, pronës, lindjes ose statuseve tjera;

**1.6 “Masat ligjore”** janë masa të cilat kanë për qëllim arritjen e barazisë së plotë të femrave dhe meshkujve në shoqëri, të cilat japin përparësi specifike në mënyrë që pjesëtarëve të gjinisë së caktuar t'u mundësohet qasje e barabartë në të gjitha fushat e jetës shoqërore, të mënjanohet pabarazia gjinore ekzistuese, ose t'u sigurohen të drejta të cilat më herët nuk iu kanë takuar.

**1.7 “ Masat e përgjithshme“** janë masa të natyrës normative, përmes të cilave diskriminimi gjinor parandalohet me anë të ligjeve të cilat i rregullojnë fushat e veçanta, sjelljet në rrethana të caktuara apo qasjen e duhur për garantimin e trajtimit të barabartë gjinor, siç janë ndëshkimet që duhet ndërmarrë ndaj individëve në rast të shkeljes së këtyre kufizimeve ose kërkesave.

**1.8 “ Masat e veçanta “** janë masa të përkohshme të cilat kanë për qëllim garantimin e të drejtave të barabarta gjinore dhe promovimin e barazisë gjinore në fushat specifike të jetës shoqërore, në të cilat është identifikuar përfaqësimi i pabarabartë gjinor apo pozita e pabarabartë e personave që i përkasin njëres gjini.

**1.9 “ Përfaqësimi i pabarabartë”** është atëherë kur përfaqësimi i njëres gjini, në një fushë të posaçme shoqërore apo në një segment të kësaj fushe, është më i ulët se 40%.

### Neni 3

## INSTITUCIONET DHE ORGANET UDHËHEQËSE

1. Në kuadër të komunës së Hanit të Elezit, funksionon zyra për barazi gjinore, e cila është e themeluar në bazë të rregullores për klasifikimin dhe sistematizimin e vendeve të punës. Zyra për barazi gjinore e komunës është zyra e cila njëkohësisht merret me ankesat dhe kërkesat e qytetarëve të cilët janë të pakënaqur dhe ndihen të diskriminuar në aspektin gjinorë.

2. Me zbatimin e masave ligjore dhe afirmative vendoset pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve në organet e të gjitha niveleve të institucioneve publike, në mënyrë që pjesëmarrja në këto institucione të arrijë nivelin e pjesëmarrjes së tyre te popullata e përgjithshme e Komunës

3. Pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve arrihet në rastet kur pjesëmarrja e një gjinie në institucione, organe apo në nivele të pushtetit është 40 %.

4. Gjatë emërimit në pozita të larta të institucioneve komunale, duhet të respektohet pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve në përputhje me paragrafin 2.
5. Organet kompetente gjatë emërimit të anëtarëve të këshillave, komisioneve dhe organeve përfaqësuese brenda dhe jashtë Komunës duhet të përfillin përfaqësimin e barabartë të femrave dhe meshkujve në këto këshilla, komisione dhe organe përfaqësuese.
6. Institucionet komunale, në pajtim me kompetencat e tyre, promovojnë dhe krijojnë mundësi të barabarta, hartojnë politikat e tyre duke u bazuar në barazinë gjinore dhe miratojnë masa dhe ndërmarrin aktivitete të nevojshme për krijimin e mundësive të barabarta për femra dhe meshkuj.

#### **Neni 4 Vendimarrja**

1. Vendimet që marrin organet e qeverisjes si, Kuvendi Komunal dhe Kryetari i Komunës, para miratimit duhet të shqyrtohen në aspektin e barazisë gjinore.
2. Shërbimi civil në saje të paanshmërisë, profesionalizmit, përgjegjshmërisë reflekton barazinë gjinore.
3. Nëpunësit civilë kanë të drejtë në trajtim të barabartë në të gjitha aspektet e menaxhimit të personelit, duke përfshirë karrierën, shpërblimet, kompensimin dhe mbrojtjen ligjore, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi fetar, politik, aftësitë e kufizuara, kushtet, statusi martesor, mosha ose prejardhja etnike.

#### **Neni 5 PARTITE POLITIKE**

1. Partite politike të regjistruara në regjistrin e partive politike, përcaktojnë metodat dhe masat për përfshirjen dhe përfaqësimin e grave dhe burrave në pajtim me nenin 3.2 të ligjit për barazi gjinore.
2. Përfaqësimi gjinor në kryesitë e partive politike, brenda komisioneve apo koalicionit të partive politike rregullohet sipas legjislacionit në fuqi të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

#### **Neni 6 Ekonomia dhe arsimi**

1. Komuna gjatë planifikimit të buxhetit komunal, të bëjë identifikimin e nevojave të burrave, grave, djemve dhe vajzave, në mënyrë të barabartë të hartoj buxhetin e ndjeshëm gjinorë.
2. Në procesin e planifikimit të buxhetit, komuna të siguroj mbajtjen e tubimeve, dëgjimeve publike dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e grave.
3. Komuna të bëjë stimulimin e programeve për gratë ndërmarrëse nëpërmjet krijimit të mundësive të barabarta për qasje në pronë dhe kredi lehtësira.

## **Neni 7** **Mbrojtja Sociale**

Në legjislacionin komunal të politikave të mbrojtjes sociale të mundësohet qasja e plotë dhe e barabartë duke rritur numrin e shërbimeve për gratë e varfëra dhe kryefamiljare.

## **Neni 8** **Shoqëria civile dhe barazia gjinore**

Komuna nëpërmjet zyrës për barazi gjinore duhet të bashkëpunojë me organizatat joqeveritare dhe grupet e tjera të shoqërisë për avancimin e barazisë gjinore në komunën e Hanit të Elezit duke iu referuar nenit 11 të Ligjit për barazi gjinore.

## **Neni 9** **Punësimi**

1. Kriteret dhe kushtet për zgjedhjen e kandidateve për vende pune në çdo degë veprimtarie, në të gjitha shkallët profesionale, në sektorin publik dhe privat, vendosën mbi bazat e barazisë gjinore, duke mundësuar punësim të barabartë të meshkujve dhe femrave.
2. Ndalohet diskriminimi mbi bazat gjinore në rast të zvogëlimeve dhe mbylljes së vendit të punës.

## **Neni 10** **Planet për barazi gjinor**

1. Çdo drejtori në konsultim me zyrën për barazi gjinore duhet që për çdo vit të hartoj një plan për barazi gjinore me synime konkrete. Plani hartohet paralel me buxhetin dhe planin e veprimtarisë. Njëkohësisht me llogarinë vjetore ekonomike duhet të bëhet edhe llogaria vjetore për barazi gjinore.
2. Shefat e sektorëve dhe drejtorët e drejtorive janë përgjegjës kryesorë rreth punës rrespektimit të barazisë gjinore brenda çdo drejtorie.

## **Buxhetimi gjinor Neni 11**

1. Çdo drejtori gjate draftimit te planeve buxhetore komunale duhet të ketë parasysh komponentën e ndarjes së drejte buxhetore e cila nuk nënkupton ndarje te veçantë të mejeve fiandare për gratë, por planifikimin dhe zbatimin e nevojave ne menyre të barabartë.
2. Buxhetimi i drejtë gjinor bëhet sipas mbledhjes dhe analizën e të dhënave statistikore të cilat i mbledhin, i evidentojn dhe i përpunojnë organet lokale, shërbimet dhe institucionet publike, ndërmarrjet publike dhe private si dhe subjektet tjera sipas strukturës gjinore.
3. Zyra për barazi gjinore do të ndihmojë në mbledhjen, evidentimin dhe anlizën e të dhënave te çdo lloj anketimi tjetër për t'u ardhur në ndihmë drejtorive dhe shërbimeve të tjera komunale në rast nevoje të hartimeve të dokumenteve të barazisë gjinore.

## **Dispozitat kalimtare Neni 12**

### **Hyrja në fuqi**

1. Kjo Rregullore hynë në fuqi, datën e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Nr. 121 / 2013  
Më dt 01 / 03 / 2013  
Hani i Elezit

  
Kryesuesi i Kuvendit  
Menduh Vlasi